# DËSHMI ARKIVI

**A-470224**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mali i Zi ndalon 24 tonë mish të skaduar drejt Kosovës, ngarkesa ishte në 1,300 pako - Informohu siç du het |
| ADRESA | `https://radar.al/mali-i-zi-ndalon-24-tone-mish-te-skaduar-drejt-kosoves-ngarkesa-ishte-ne-1300-pako/` |
| BURIMI | radar.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 20:14:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 20:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8f1232ca9c7c3484dcfe04a456dc19523e2e90252fc35993407e1e3efec84961` |
| TEKSTI | `42c7a3c4deb0ea4754fa870688fe032ec47b4645a00b489cdfd80fdfef09afb7` |
| PAMJA | `ec58565596c800443f50cbb8acd5fb82091255ff88af148f34b47b3708336247` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `74c315b87f9c3af4b00085ef7f4882e843d19fabe480a7294d2b6b3a47795ed1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/74c315b87f9c3af4b00085ef7f4882e843d19fabe480a7294d2b6b3a47795ed1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË

# Mali i Zi ndalon 24 tonë mish të skaduar drejt Kosovës, ngarkesa ishte në 1,300 pako

SEPTEMBER 25, 2026



Dogana e Malit të Zi  njoftoi më 25 shtator se ka ndaluar në Portin e Tivarit një kontejner me mish të ngrirë gjedhi me afat të skaduar, të destinuar për kompaninë “Apetit SHPK” nga Kosova.Ky kontejner, sipas njoftimit, përmbante mbi 24 tonë peshë të përgjithshme të mishit, të shpërndarë në rreth 1.300 pako.

Sipas autoriteteve malazeze afati i përdorimit të mishit kishte skaduar më 14 maj të këtij viti.

Në një reagim për rastin, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) tha se kompania Apetit është duke iu nënshtruar masave të rrepta të kontrollit qysh nga 18 shtatori.

“Pavarësisht kësaj, nga data 18 shtator AUV menjëherë ka iniciuar kontroll të detajuar. Biznesi është duke u mbajtur nën mbikëqyrje të vazhdueshme nga data e nisjes se inspektimeve. Informacionet e reja të pranuara sot, do të përfshihen dhe plotësojnë kontrolli e plotë ne vijimësi”, tha ajo.

AUV tha se ka urdhëruar gjurmueshmëri të plotë të produkteve të importuara nga Apetit, përfshirë verifikimin e dokumenteve të origjinës dhe importit, sasive të importuara e të shpërndara dhe destinacioneve të produkteve.

Agjencia shtoi se më herët ka marrë edhe mostra për analiza, ndërsa çdo ngarkesë e operatorit po i nënshtrohet kontrolleve shtesë në kufi. Në të njëjtën kohë, inspektorati po kontrollon sasitë e produkteve në depo dhe ato që janë vendosur në treg.

Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar kompaninë “Apetiti SHPK” për të marrë koment lidhur me këtë çështje, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje.

Ky është rasti i dytë i njoftuar nga autoritetet doganore malazeze, pas ndalimit paraprak të tre kontejnerëve me mish gjedhi, me peshë bruto prej rreth 77.8 tonësh.

Në rastin e mëparshëm, sipas Doganës malazeze, “etiketat origjinale që tregonin afatin e skaduar ishin hequr dhe zëvendësuar me etiketa që shënonin një afat tjetër përdorimi”.

Sipas Doganës, mishi nga këta tre kontejnerë do të asgjësohet pas përfundimit të procedurave ligjore.

Vetëm në shtatë muajt e parë të këtij viti, mbi 50 milionë euro mish gjedhi dhe pule janë importuar në Kosovë nga Brazili.

Ndërkaq nga 3 shtatori, Bashkimi Evropian i ka vënë kufizime importit të një pjesë e eksporteve me origjinë shtazore nga Brazili

Demo

## Postimet e reja

**Mali i Zi ndalon 24 tonë mish të skaduar drejt...**
SEPTEMBER 25, 2026

**Putin kërcënon Ukrainën: Do të vuajë pasojat e...**
SEPTEMBER 25, 2026

**Aksident i rëndë, alpinisti 28-vjeçar humb jetën pa...**
SEPTEMBER 25, 2026

**Rama në OKB: Algoritmi krijoi narrativën e trillua...**
SEPTEMBER 25, 2026

## Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

**Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive**

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

**ALERT në Slloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu**

**Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të “Top Fruits” të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq**

**Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare**

## Na ndiq



Arsyeja lidhet me rregullat e BE-së për përdorimin e antimikrobikëve te kafshët që përfundojnë në zinxhirin ushqimor./REL

kosova Mali i Zi mish i skaduar

SHARE.

Facebook Instagram YouTube TikTok

RRETH NESH

radar.al

Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

**NIPT:** M47705501A
**Email:** radarlajme@gmail.com
**Kontakt:** +355689008000

HOROSKOPI

**Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026**

**Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot**

**Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator**


Aleanca për Media Etike
Artikull joetik?
raporto këtu


© Radar.al. dizenjuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.